



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

RREGULLORE E BRENDËSHME E PUNËS

- Miratuar me Vendimin e Brendshëm të PZAP-it Nr. 217, datë 24.08.2012 –

PËR STANDARDET E ORGANIZIMIT TË BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TE PUNES

“TË PANELIT ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA – PZAP”

Në zbatim të nenit 115 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-073, i cili është ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-256, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP-së), mbi Emërimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP-i), bazuar në nenin 123 të Ligjit të cekur me lartë ku PZAP-i, në ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësi të tij ndihmohet nga Sekretariati i cili punon në pajtim me këtë ligj dhe duke u bazuar në Rregulloren Nr. 09/2012 Për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, PZAP-i harton këtë rregullore te brendshme të punës për institucionin tij.

KAPITULLI I

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Institucioni i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP - i, është i organizuar dhe funksionon në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-073, i cili është ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-256, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP-së), me Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it si dhe me këtë Rregullore te brendshme te punes që tash e tutje do të quhet Rregullore për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës.

Neni 2

Mbi bazën e akteve të mesipërme, Rregullorja përcakton rregullat e veprimtarisë së Institucionit, kompetencat e Panelit të PZAP-it dhe kompetencat shërbyesve civil të Sekretariatit të PZAP-it.

Neni 3

PZAP-i është organ i përhershëm, i pavarur, kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat dhe apelet e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor siç është përcaktuar me ligj dhe me Rregullat Zgjedhore.

Neni 4

Veprimtaria e Institucionit zhvillohet mbi bazën e parimeve të pavarësisë, paanësisë, profesionalizmit, konfidentalitetit dhe fleksibilitetit në përmbushjen e qëllimeve të Institucionit, të drejtat dhe detyrimet e procesve zgjedhore të përcaktuara me LZP-së dhe Rregullat e cekura me lartë.

Neni 5

PZAP përbëhet nga dhjetë (10) anëtar, përfshirë edhe Kryetarin e Panelit .

Neni 6

Anëtarët e Panelit do t'i plotësojnë detyrat e veta me kohë dhe në mënyrë objektive, të paanshme dhe apolitike, si dhe do t'i mbajnë konfidenciale të gjitha informatat e dorëzuara tek ata në cilësinë e anëtarëve të Panelit.

Neni 7

Emërimi i anëtarëve të PZAP-it, duke përfshirë këtu edhe kryetarin, është bërë nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës me vendimin Agj.nr. 685/2010 të datës 08.11.2010 në bazë të nenit 115.1 të LZP-së, dhe nenit 9 paragrafi 2 i Ligjit Nr. 03/L-256, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës i cili përcakton se: Kryetari i Gjykatës Supreme emëron Kryetarin e PZAP-it nga mesi i gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe anëtarët e PZAP-it nga mesi i gjyqtarëve të Gjykatave të Qarkut në Kosovë.

KAPITULLI II

STRUKTURA E ORGANIZIMIT TË BRENDSHËM DHE DREJTIMI I INSTITUCIONIT

Neni 8

Struktura e Institucionit të PZAP-it

Struktura e Institucionit të PZAP-it përcaktohet nga Kryetari i PZAP-it, anëtarët e tij dhe Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Sekretariatit të PZAP-it, në bazë të Ligjit Nr. 03/L-256, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Ligjeve tjera relevante të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Struktura e PZAP-it përbëhet nga:

- Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP-i), përbëhet nga:
 - a) Kryetari i PZAP-it dhe
 - b) Anëtarët e PZAP-it (nëntë (9) anëtarë);
- Sekretariati i PZAP-it), përbëhet nga:
 - a) Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe
 - b) Asistenti/ja Ekzekutiv/e i/e Kryetarit dhe i Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv;

- Drejtoria Ligjore e Sekretariatit të PZAP-it), përbehet nga:
 - a) Drejtori i Drejtorisë dhe
 - b) Tre (3) Zyrtar të Lartë Ligjorë;
- Drejtoria e Administratës dhe Buxhetit), përbehet nga:
 - a) Drejtori i Drejtorisë;
 - b) Zyra për Përkthime – Koordinator i Përkthimeve;
 - c) Zyra për Teknologji Informative dhe Logjistikë - Zyrtari i Teknologjisë Informative dhe Logjistikës dhe
 - d) Zyra e Transportit - Zyrtari i Transportit.

Në varësi të prioriteteve të përcaktuara nga Kryetari dhe anëtarët e PZAP-it si dhe nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Sekretariatit, kjo strukturë është e ndryshueshme në çdo kohë.

Paraqitja në mënyrë skematike e strukturës përcakton edhe varësin ose jo të strukturave të mësipërme nga njëra tjetra.

Neni 9

DREJTIMI I INSTITUCIONIT

Kryetari dhe anëtarët e PZAP-it

Institucioni i PZAP-it drejtohet nga Kryetari i PZAP-it, i cili autoritetin e tij e ushtron nëpërmjet këshillave, udhëzimeve, porosive të lëshuara prej tij, të cilat mund të jenë me shkrim dhe në mënyrë verbale.

Kryetari i PZAP-it, disa prej kompetencave të tij mund t'ua delegoj anëtarëve të panelit, Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të Sekretariatit, apo personave të veçant përmes një autorizimi me shkrim – ose në mënyrë verbal.

Neni 10

Në ushtrimin e funksionit të tij Kryetari i PZAP-it, ndihmohet nga dy (2) Komisione të përhershme: a). Komisioni për Çështje Ligjore i PZAP-it, i përberë nga pesë (5) anëtarë të PZAP-it, i cili në mënyrë të përhershme do të merret me çështjet ligjore që kanë të bëjnë me fushën e kompetencave dhe të mandatit të Institucionit të PZAP-it, të përcaktuar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) në Republikën e Kosovës dhe amendamentimin e Rregullave dhe Procedurave të brendshme të PZAP-it dhe b). Komisioni për Buxhet dhe Personel i përberë nga pesë (5) anëtarë të PZAP-it, i cili do të merret me çështjet e buxhetit dhe të personelit të PZAP-it.

Këto Komisione koordinohen nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Sekretariatit dhe Drejtori i Drejtorisë Ligjore të Sekretariatit të PZAP-it;

Këto komisione mbledhen sa herë që e gjykon të nevojshme Kryetari i Panelit të PZAP-it dhe ka vetëm karakter këshillimor. Në mbledhje mund të ftohen edhe punonjes të tjerë kur çmohet e arsyeshme nga Kryetari i Panelit të PZAP-it.

SEKRETARIATI

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Sekretariatit të PZAP-it

Sekretariati i PZAP-it drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i cili është nëpunësi më i lartë civil në Institucionin e PZAP-it, funksionet dhe përgjegjësitë e të cilit janë të përcaktuara me ligj "Statusi i Shërbyesit Civil", Kodi i Etikës, si dhe me ligjet dhe aktet e tjera nënligjore relevante.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv është nëpunësi më i lartë civil në Institucionin e PZAP-it dhe është përgjegjës për administrimin dhe udhëheqjen e gjithëmbarshme të Sekretariatit dhe sigurimin për zbatimin e të gjitha funksioneve të besuara;

Menaxhon organizimin e punës së Sekretariatit dhe nxjerrjen e procedurave administrative për çfarëdo çështje që ka të bëjë me funksionet e PZAP-it;

Menaxhimin efektiv dhe efikas të burimeve njerëzore dhe financiare të Sekretariatit;

Vepron në varësi direkte nga Kryetari i PZAP-it dhe përgjigjet para tij për veprimtarinë e strukturave të Institucionit që ai ka në varësi;

Nëpërmjet ushtrimit të funksioneve dhe të bashkërendimit të punës së strukturave të institucionit, kujdeset dhe siguron qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë e veprimtarive që kërkojnë bashkëpunim me institucionet e tjera;

Kryen detyra për bashkërendimin e strukturave të institucionit për zbatimin e politikave të miratuara në fushën e veprimtarisë së tij;

Kryen detyra në përputhje me kërkesat e parashikuara në ligj dhe akte të tjera nënligjore, si dhe me urdhrat apo detyrat e marra nga Kryetari i PZAP-it;

Merr masa për shfrytëzimin e frytshëm të burimeve njerëzore, të mjeteve financiare e burimeve materiale të institucionit;

Ndjek zbatimin e rregullave të Etikës dhe të Rregullores së Brendshme të institucionit nga punonjësit e institucionit, njofton titullarin për rastet e shkeljeve si dhe zbaton rekomandimet e Kryetarit të PZAP-it duke marrë vendimet e nevojshme sipas legjislacionit përkatës;

Ka për detyrë përmirësimin e standardeve në të gjitha shërbimet e ofruara nga Institucioni. Ai përgatit analiza dhe bën propozime për mbarrëvajtjen e punës së institucionit;

Me anë të strukturave që ka në varësi përgjigjet për sigurimin e kushteve të punës për veprimtarinë normale të Institucionit.

Organizimin e agjendës së takimeve të PZAP-it nën udhëheqjen e Kryetarit të PZAP-it dhe sigurimin e materialit të nevojshme para çdo takimi;

Ndërmerr veprime për përgatitjen e paneleve të PZAP-it duke siguruar se i tërë materiali i nevojshëm për mbajtjen e takimit të punës së panelit është në dispozicion;

I raporton PZAP-it për të gjitha detyrat e Sekretariatit;

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv është përgjegjës që rekrutimi dhe pranimi në Zyrën e Sekretariatit të bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësive profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta dhe në bazë të konkursit publik;

Zbatimin e politikave jo-diskriminuese ndaj personelit të Sekretariatit, përfshirë përfaqësimin e drejtë gjinor në të gjitha nivelet dhe garantimin që përbërja e stafit të Sekretariatit e reflekton karakterin shumetnik të Kosovës;

Sigurimin e rekrutimit, gradimit dhe menaxhimit të nëpunësve civil të Sekretariatit të PZAP-it në bazë të parimit të meritës, respektivisht emërimi i kandidatit me të mirë për një pozitë në administratën publike si dhe njohje pranim dhe vlerësimi i rezultateve të nëpunësit civil gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.

Neni 12

Asistenti/e Ekzekutive i/e Kryetarit të PZAP-it dhe Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të Sekretariatit të PZAP-it

Me qëllim të lehtësimit dhe funksionimit të zyrës së Kryetarit të PZAP-it dhe Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të Sekretariatit të PZAP-it, bën organizimin dhe zbatimin e të gjitha punëve administrative të zyrës në mënyrë profesionale;

Asistenti/ja Ekzekutive i/e Kryetarit të PZAP-it dhe Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të Sekretariatit të PZAP-it, kryen të gjitha detyrat dhe porositë e dhëna me gojë ose me shkrim nga mbikqyrësit e saj të drejtëpërdrejtë. Ajo organizon punën për pritjen e palëve që ju ka lënë takim Kryetari i PZAP-it dhe Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Sekretariatit të PZAP-it, evidenton telefonatat dhe kërkesat e personave për takim, konfirmon takimet, mban axhendën e takimeve dhe kujdeset për respektimin e saj, si dhe kompjuterizon të gjitha materialet sipas porositë të Kryetarit të PZAP-it dhe Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të Sekretariatit të PZAP-it.

Neni 13

DREJTORIA LIGJORE E SEKRETARIATIT TË PZAP-it

Drejtori i Drejtorisë Ligjore

Drejtori i Drejtorisë Ligjore është nën vartësinë e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të Sekretariatit dhe punon për zbatimin e urdhërimit të veçantë të Kryetarit dhe anëtarëve të PZAP-it në kuadër të kompetencave dhe mandatit të PZAP-it të përcaktuar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP-së).

Drejtori i Drejtorisë Ligjore është përgjegjëse për menaxhimin dhe koordinimin e punës së Drejtorisë Ligjore të Sekretariatit të PZAP-it i cili ka për qëllim ndërmarrjen e veprimeve dhe aktiviteteve të duhura për të gjitha çështjet administrative të ndërlidhura me funksionimin e Panelit të PZAP-it, përgatitjen e paneleve të PZAP-it duke siguruar se i tërë materiali i nevojshëm është në dispozicion për seancat e panelit, zgjidhjen dhe vendosjen e të gjitha ankesave të subjekteve politike dhe palëve tjera të interesuara gjatë procesit zgjedhor në afatin ligjor, çështjet lidhur me personelin, si dhe çështjeve tjera për përmbushjen e mandatit të institucionit.

Drejtorja Ligjore e Sekretariatit të PZAP-it në kuadër të strukturës organizative ka të edhe tre Zyrtarë të Lartë Ligjore të cilët nën mbikëqyrjen e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të Sekretariatit të PZAP-it dhe Drejtorit të Drejtorisë Ligjore të Sekretariatit të PZAP-it kanë përgjegjësi komplekse për ta mbështetur punën profesionale të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP-i) dhe Sekretariatit të PZAP-it për çështje administrative që kanë të bëjnë me Personelin dhe Financat të ndërlidhura me funksionimin e PZAP-it.

Neni 14

DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE BUXHETIT

Drejtori i Drejtorisë së Administratës dhe Buxhetit

Drejtori i Drejtorisë së Administratës dhe Buxhetit i cili është edhe Zyrtar Kryesor Financiar (ZKF) në Sekretariatit të PZAP-it është nën vartësinë e Drejtorit të

Përgjithshëm Ekzekutiv të Sekretariatit të PZAP-it dhe punon për zbatimin e urdhërit të veçantë të Kryetarit dhe anëtarëve të PZAP-it në kuadër të kompetencave dhe mandatit të PZAP-it të përcaktuar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP);

Drejtori i Drejtorisë së Administratës dhe Buxhetit në Sekretariatit e PZAP-it është përgjegjës për Udhëheqjen, koordinimin, planifikimin, monitorimin dhe vlerësimin e punës së Drejtorisë së Administratës dhe Buxhetit, respektivisht zbatimin e politikave institucionale për qështjet lidhur me buxhetin, financat, përkthimin e dokumenteve, Teknologjinë Informative&Logjistikës, si dhe Transportin;

Drejtorja e Administratës dhe Buxhetit në Sekretariatit e PZAP-it në kuadër të strukturës organizative përbehet nga: Zyra për Koordinimin e Përkthimeve, Zyra për Teknologji Informative dhe Logjistik si dhe Zyra e Transportit të cilat nën mbikëqyrjen e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të Sekretariatit të PZAP-it dhe Drejtorit të Drejtorisë së Administratës dhe Buxhetit mbështet punën profesionale të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP-i) dhe Sekretariatit të PZAP-it për çështje administrative që kanë të bëjnë me Buxhetin, Financat, Koordinimin dhe përkthimin e dokumenteve në gjuhët zyrtare, Teknologjisë Informative dhe Logjistikë, si dhe të Transportit, të cilat ndihmojnë në lehtësimin dhe funksionimin e PZAP-it.

KAPITULLI III

FUNKSIONIMI I INSTITUCIONIT

Neni 15

Institucioni i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP-i, funksionon në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-073 i cili është ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-256, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP-së), me Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it si dhe me këtë Rregullore të brendshme të punës që tash e tutje do të quhet Rregullore për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës.

Neni 16

Funksionet dhe Përgjegjësit e Sekretariatit të PZAP-it

Në bazë të LZP-së, neni 123, PZAP në ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësi të tij ndihmohet nga Sekretariati i cili punon në pajtim me këtë ligj.

Sekretariati i PZAP-it:

- a) pranon ankesa dhe apele;
- b) arkivon, përkthen dhe harton rastet;
- c) mirëmban adresa zyrtare dhe qasje në informatat në çdo kohë rreth vendimeve të PZAP-it në të gjitha gjuhët zyrtare sipas Ligjit për Përdorimin e gjuhëve.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Sekretariatit të PZAP-it nën udhëheqjen e Kryetarit të PZAP-it, është përgjegjës për:

- a) të gjitha çështjet administrative të ndërlidhura me funksionimin e PZAP-it;
- b) përgatitjen e paneleve të PZAP-it duke siguruar se i tërë materiali i nevojshëm është në dispozicion;
- c) organizimin e Sekretariatit dhe nxjerrjen e procedurave administrative për çfarëdo çështje që ka të bëjë me funksionimin e PZAP-it;

- d) Për menaxhimin e buxhetit vjetor të ndarë nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për të mbuluar shpenzimet për funksionimin e duhur të Sekretariatit.

KAPITULLI IV

Neni 17

Emërimi dhe largimi nga detyra i personelit të Sekretariatit të PZAP-it

Kushtet për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të Sekretariatit të PZAP-it, të Drejtorëve të Drejtorive dhe të Zyrtareve tjerë të Sekretariatit të PZAP-it janë ato të parashikuara në Ligjin me nr. 03/L-149, Për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës të datës 13.05.2010, i Shpallur me dekretin Nr. DL-022-2010 datë 14.06.2010 nga Presidenti i Republikës së Kosovës si dhe në ato specifike që caktohen gjatë konkursit për çdo vend të veçantë pune.

Të gjithë nëpunësit civil të Institucionit fillojnë në detyrë apo largohen nga detyra apo u jepen masa disiplinore me urdher me shkrim të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të Sekretariatit në bazë të dispozitave të përcaktuara me Ligjin Mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

KAPITULLI V

Dispozitat e fundit

Neni 18

Të gjithë nëpunësit civil të këtij Institucioni, janë të detyruar që funksionet dhe përgjegjësit e tyre në përputhje me LZP, Rregullat Zgjedhor, Rregullat e Procedurat e PZAP-it, me ligjet tjera relevante dhe me këtë Rregullore, t'i zbatojnë me përpikmëri.

Neni 19

Orari i punës i institucionit përcaktohet në bazë të Ligjit Mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës".

Neni 20

Të drejtat dhe detyrimet e punonjësve të institucionit të PZAP-it që nuk përmenden në këtë Rregullore përcaktohen/përmbahen në përshkrimin e vendit të punës së secilit prej tyre.

Neni 21

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë nga data e miratimit të saj.

Prishtinë, 24.08.2012



Shukri Sylejmani

Kryetari i PZAP-it